



2020

Ministria e Financave

**Spektori për kontroll të
brendshëm financiar publik**

PËRMBAJTJA

**RAPORT VJETOR
PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
PËR VITIN 2020**

Shkup, korrik viti 2021

PËRMBLEDHJE.....	
1.HYRJE.....	
1.1. Baza ligjore për përgatitjen e Raportit vjetor.....	
1.2. Qëllimi i Raportit vjetor.....	
1.3. Baza e përgatitjes dhe fushëveprimi i Raportit vjetor.....	
1.4. Raportet e dorëzuara financiare vjetore për vitin 2020.....	
2. GJENDJA E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR NË VITIN 2020.....	
2.1. ANALIZA E PYETËSORIT PËR VETËVLERËSIM TË SISTEMIT PËR MENAXHIM DHE KONTROLL FINANCIAR.....	
A.MJEDISI I KONTROLLIT.....	
B.MENAXHIMI ME RREZIQET.....	
C.KONTROLLI.....	
Ç.INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI.....	
D. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SISTEMIT.....	
3. RAPORT PËR REVIZIONET DHE AKTIVITETET E KRYERA TË REVIZIONIT TË BRENDSHËM VITIN NË 2020.....	
3.1 Gjendja e revizionit të brendshëm sipas evidencës së Njesisë qendrore të harmonizimit	
3.1.1 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm tek subjektet e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal.....	
3.1.2 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm tek shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal.....	
3.1.3 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm në ministri.....	
3.2 Gjendja e revizionit të brendshëm sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2020.....	
3.2.1. Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel qendror sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2020.....	
3.2.2. Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel lokal sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2020.....	
4. NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT.....	
4.1.Aktivitetet e realizuara të Njesisë qendrore të harmonizimit në vitin 2020.....	
4.1.1.Aktivitetet e Komitetit për monitorimin e zbatimit të Politikës për kontroll të brendshëm financiar në sektorin publik.....	
4.1.2 Aktivitetet në lidhje me kapitullin 32 – Kontrolli financiar	
KONKLUSIONE.....	
SHTOJCA.....	
1. Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar Raport vjetor financiar	
2. Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar Strategji për menaxhimin me rreziqet	
3. Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar Regjistër të rreziqeve	
4. Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar raport për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm	

PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik tregon nivelin e zhvillimit të menaxhimit financiar, kontrollit dhe revizionit të brendshëm me qëllim që të njoftohet Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe palët e tjera të involvuara lidhur me aktivitetet e realizuara gjatë periudhës së raportimit.

Raporti është përpiluar në bazë të raporteve të dorëzuara financiare vjetore për vitin 2020 nga shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal dhe evidencës së Njesisë qendrore të harmonizimit.

Obligimin për dorëzimin e Raportit vjetor financiar për vitin 2020 e kanë përmbushur 92% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 77% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel lokal, që në krahasim me vitin paraprak paraqet rritje prej 8 pikë përqindjeje në nivel qendror dhe zvogëlim prej 1 pikë përqindjeje në nivel lokal.

Analiza e të dhënave sa i përket vetëvlerësimeve të parashtruara tregon se 94.6% e të punësuarve të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal janë informuar lidhur me Kodin e etikës së nëpunësve shtetërorë ose kodin e posaçëm të shfrytëzuesit buxhetorë, por ekzistojnë vështirësi në raportimin dhe parandalimin e konflikteve të mundshme të interesit.

Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit tek shfrytëzuesit buxhetorë është në nivel të lartë profesional, pro nevojitet që të përmirësohet pjesëmarrja e udhëheqësve të organeve në kuadër të takimeve të nivelit më të lartë të udhëheqjes, ndërsa sa i përket qasjes së planifikimit nevojitet që të përmirësohen planet/programet vjetore të punës, duke përcaktuar qëllimet që çdo njësi organizative duhet t'i realizojë gjatë vitit.

Analiza e të dhënave lidhur me vetëvlerësimet e parashtruara tregon se edhe pse 80% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 69% të komunave dhe Qytetit të Shkupit kanë buxhet të ndarë sipas njësive organizative, vetëm 55% të udhëheqësve të njësive organizative të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendro dhe 39% e komunave dhe Qytetit të Shkupit kanë autorizime të përgjithshme për ndërmarrjen e detyrimeve financiare, që tregon se nuk janë vendosur në mënyrë të mjaftuesheshme linjat e qarta të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së udhëheqësve.

Në nivel qendror, rreth 70% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Strategjinë e menaxhimit të rreziqeve, rreth 74% e shfrytëzuesve buxhetorë i dokumentojnë rreziqet gjatë punës në regjistr të rreziqeve, ndërsa rreth 67% i dokumentojnë në dokumentet e tyre të planifikimit. Në nivel lokal, rreth 46% e shfrytëzuesve buxhetorë e kanë miratuar Strategjinë e menaxhimit të rreziqeve, rreth 40% e shfrytëzuesve të buxheut i dokumentojnë rreziqet gjatë punës në regjistr të rreziqeve, ndërsa rreth 41.9% i dokumentojnë rreziqet në dokumentet e tyre të planifikimit.

Nga gjithsej 176 shfrytëzues buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, raport për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm kanë dorëzuar 107 shfrytëzues buxhetorë ose 61% (për 2 pikë përqindjeje më pak në krahasim me vitin paraprak), përkatësisht 61 shfrytëzues buxhetorë nga niveli qendror (64%) dhe 46 shfrytëzues buxhetorë (57%) nga niveli lokal.

Analiza e të dhënave tregon se në vitin 2020 në krahasim me vitin paraprak, në nivel qendror dhe lokal, numri i përgjithshëm i revizorëve të brendshëm është rritur për 9 (6.7%), ndërsa numri i udhëheqësve është zvogëluar për 6 (8.6%).

Në vitin 2020, përqindja e rekomandimeve të realizuara të revizionit të brendshëm në nivel qendror dhe lokal është zvogëluar për 2.81% në krahasim me vitin paraprak dhe arriti 59.2%, përkatësisht 60% janë rekomandime të realizuara në nivel qendror dhe 58.4% në nivel lokal.

Për tejkalimin e dobësive të konstatuara, në këtë raport jepen konkluzione për zbatimin e të cilave Ministria e Financave – Sektori i kontrollit të brendshëm financiar publik do të njoftojë Qeverinë në Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2021.

1. HYRJE

Sektori për Kontroll të brendshëm financiar publik në Ministrinë e Financave, si Njësi qendrore e harmonizimit (NJQH) është njësi organizative kompetente për harmonizimin e aktiviteteve për zhvillimin e sistemit të kontroleve të brendshme financiare në sektorin publik. Në bazë të Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik¹, NJQH-ja është kompetente për përgatitjen e Raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Raporti vjetor ka për qëllim që ta paraqesë gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal.

Sistemi i kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik vendoset për shkak të sigurimit të menaxhimit të mirë financiar (sound financial management), që nënkupton realizimin e qëllimeve të përcaktuara në mënyrë etike, duke shfrytëzuar mjetet në mënyrë të ligjshme, korrekte, ekonomike, efektive dhe efikase.

Për shkak të kompleksitetit të tij, kontrolli i brendshëm financiar kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, që kryhet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit nga udhëheqësia, si dhe aktiviteteve të revizionit të brendshëm dhe të jashtëm.

Në bazë të asaj që u potencua më sipër, perceptohet shkalla e zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në vitin 2020, ndërsa në Raportin vjetor janë dhënë edhe masat për zhvillimin e mëtejshëm të tij.

1.1. Baza ligjore për përgatitjen e Raportit vjetor

Në përputhje me nenin 48, alinea 11 të ligjit, Raporti vjetor përgatitet në bazë të analizës së pyetësorit për vetëvlerësim të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Raportit për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm të dorëzuar me raportin financiar vjetor nga shfrytëzuesit buxhetorë pranë Ministrisë së Financave, si dhe aktivitetet e Njesisë qendrore të harmonizimit lidhur me zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.

1.2. Qëllimi i Raportit vjetor

Qëllimi i Raportit vjetor është vështrimi i plotë i shkallës së zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar, si dhe informimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe palëve të tjera të involvuara për aktivitetet e realizuara në vitin 2020 dhe përcaktimi i aktiviteteve për zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe revizionit të brendshëm.

1.3. Baza e përgatitjes dhe fushëveprimi i Raportit vjetor

Raporti vjetor për vitin 2020 është përgatitur në bazë të analizës së:

¹“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 90/2009, 188/2013 dhe 192/15

- Pyetësorit të plotësuar për vetëvlerësim të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, si pjesë e raporteve të dorëzuara për aktivitetet lidhur me krijimin dhe zhvillimin e menaxhimit dhe kontrollit financiar;
- Raportit të dorëzuar për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm dhe
- Deklaratës së dorëzuar për cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm.

Si dhe raportet e dorëzuara financiare:

- Raporti për mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara sipas zërave (pasqyrë krahasuese tabelare);
- Raporti për programet, projektet dhe marrëveshjet e realizuara;
- Llogaritë vjetore ose llogaritë vjetore të konsoliduara dhe
- Raporti për vetëvlerësimin e kryer nga ministritë dhe organet tjera të administratës shtetërore, shfrytëzuesit e linjës së parë buxhetore, komunat dhe Qyteti i Shkupit.

1.4. Raportet e dorëzuara financiare vjetore për vitin 2020

Obligim për dorëzimin e raporteve financiare vjetore (RFV) në vitin 2020 kishin 175² shfrytëzues buxhetorë, prej të cilëve 94 janë në nivel qendror dhe 81 në nivel lokal (komunat dhe Qyteti i Shkupit).

Në nivel qendror, në vitin 2020 RFV dorëzuan 86 shfrytëzues buxhetorë, që krahasuar me vitin paraprak është rritje prej 8 pikë përqindjeje dhe 62 njësi të vetëqeverisjes lokale dorëzuan RFV, që krahasuar me vitin paraprak është rënie prej 1 pikë përqindjeje.

Tabela 1: Shqyrtim lidhur me numrin e shfrytëzuesve buxhetorë që ishin të detyruar të dorëzonin RFV për vitin 2020 dhe shfrytëzuesve buxhetorë që dorëzuan RFV

Shfrytëzuesit buxhetorë	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë që duhet të dorëzojnë RFV	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë që dorëzuan RFV	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë që nuk kanë dorëzuar RFV	% e shfrytëzuesve buxhetorë që nuk kanë dorëzuar RFV		Ritje/ zvogëlim (pikë përqindje) 2019-2020
				2019	2020	
Niveli qendror	94	86	8	16%	8%	8
Niveli lokal	81	62	19	22%	23%	-1
Gjithsej	175	148	27	19 %	15%	4

(Shtojca 1. Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar Raport vjetor financiar).

² Komisioni për Parandalimin dhe Mbrotjen nga Diskriminimi nuk është i përfshirë sepse nuk ka aktivitete afariste në vitin 2020.

2. GJENDJA E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR NË

VITIN 2020

2.1. ANALIZA E PYETËSORIT PËR VETËVLERËSIM TË SISTEMIT PËR MENAXHIM DHE KONTROLL FINANCIAR

Për shkak të kompleksitetit të tij, sistemet e kontrollit të brendshëm kërkojnë monitorim dhe vlerësim të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit përmes:

- vetëvlerësimit të sistemeve të zbatuara nga udhëheqësia dhe
- aktiviteteve të revizionit të brendshëm dhe të jashtëm.

Vetëvlerësimi i sistemeve kryhet me plotësimin e Pyetësorit për vetëvlerësimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, duke iu përgjigjur pyetjeve të grupuara në komponentët vijues:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi me rreziqe;
- Kontrolli;
- Informacioni dhe komunikimi dhe
- Monitorimi.

A. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit përfshin sferat vijuese:

- Etika dhe integriteti - integriteti personal dhe profesional, përkatësisht vlerat etike të të punësuarve dhe kompetencat e tyre;
- Mënyra e udhëheqjes dhe stili i menaxhimit;
- Ekzistenca e qasjeje së planifikimit në punë (përcaktimi i misionit, vizionit, vendosja e qëllimeve strategjike dhe lidhja e tyre me qëllimet operative, përkatësisht qëllimet vjetore);
- Strukturë organizative e organizuar me autorizime dhe përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të qartë për zbatimin e qëllimeve dhe menaxhimin e mjeteve buxhetore dhe
- Vendosja e linjave raportuese për qëllimet e arritura dhe mjetet e shpenzuara buxhetore.

a) Etika dhe integriteti

Analiza e të dhënave nga vetëvlerësimi i parashtuar tregon se të punësuarit në rreth 95% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal janë të informuar lidhur me Kodin e etikës së nëpunësve shtetërorë. Megjithatë, ekziston ende një numër i vogël i organizatave të sektorit publik që kanë Kodin e tyre të veçantë të etikës, i cili publikohet në ueb faqen e

tyre të institucionit, me ç'rast të punësuarit informohen lidhur me të dhe me vlerat etike të institucionit.

Ende ekziston një vështrim i thjeshtësuar në organizatat e sektorit publik se vendimet rregullohen ose me ligj ose me vullnet të lirë. Kjo çon në supozimin e gabuar se nëse diçka është e ligjshme duhet të jetë etike dhe sfera e etikës nuk njihet. – етика. Si rezultat, shpesh lindin mosmarrëveshje dhe **dilema etike** dhe e mira dhe e keqja nuk mund të njihen dhe përcaktohen qartë.

Kodi i etikës në praktikë duhet të kontribuojë që të punësuarit të fillojnë të mendojnë për çështjet etike përpara se të përballen me to dhe t'u mundësohet atyre që të refuzojnë kryerjen e aktiviteve joetike, përkatësisht të përcaktojnë kufijtë midis sjelljes së pranueshme dhe të papranueshme. Gjithashtu, kodi i etikës dhe udhëzimet për zbatimin e tij duhet t'u ndihmojnë të punësuarve në prezantimin dhe mësimin mbi sjelljen etike, ndërsa udhëheqësit duhet të përcaktojnë qartë atë që ata vlerësojnë si sjellje joetike si parandalim i rrezikut të dëmtimit të reputacionit të institucionit.

Numri i organizatave të sektorit publik që kanë konstatuar situata të mundshme të konfliktit të interesit dhe masat për parandalimin e konflikteve të mundshme të interesit është i vogël, po ashtu nuk është emëruar person i autorizuar për etikë dhe nuk është caktuar mënyra e veprimit ndaj rasteve të raportuara të sjelljes joetike përkatësisht nuk krijohen struktura etike në institucionet e sektorit publik, si p.sh.: **komitetet e etikës** si një grup ekzekutuesish që mbikëqyrin sjelljen etike në institucion dhe menaxhojnë lëndët diskutabile dhe disiplinimin e atyre që bëjnë gabime dhe njësi **етика** që punojnë si qendra këshillimi që ndihmojnë të punësuarit të ballafaqohen me problemet ose çështjet e përditshme dhe të zbatojnë programe të specializuara trajnimi.

Tabela 2: Rezultatet nga sfera “Etika dhe integriteti”

Etika dhe integriteti	Viti 2020							
	Niveli qëndror		Niveli lokal		Gjithsej		2019	+/- 2020-2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numë r	%	Nu mër	%	Num ër	%		
Njohja e të punësuarve me Kodin e etikës së nëpunësve shtetëror ose kodin e posaçëm të shfrytëzuesve buxhetorë.	81	94,2	59	95,16	140	94,6	94,3	0,3
Person i emëruar (i autorizuar) për etikë	13	15,1	5	8,1	18	12,2	10	2,2
Ekzistimi i udhëzimeve interne shtesë dhe/ose udhëzimeve për sjelljen e të punësuarve	53	61,6	23	37,1	76	51,3	49,6	1,7
Ekzistimi i rregullave të qarta (aktet interne) që përcaktojnë situatat e konfliktit të mundshëm të interesit dhe mënyrën e veprimit.	36	41,9	17	27,4	53	35,8	36,2	-0,4

b) Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit

Analiza e të dhënave të pranura tregon se udhëheqësia dhe stili i menaxhimit tek shfrytëzuesit buxhetorë është në nivel të lartë profesional, mbahen takime të rregullta në nivel më të lartë menaxherial (kolegjiume) dhe lidhur me to rregullisht diskutohen tema që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe kontrollin financiar (realizimi i qëllimeve strategjike, zbatimi i programeve dhe projekteve, shkalla e rezultateve të arritura, rreziqet kryesore gjatë punës dhe zbatimi i planit/buxhetit financiar).

Krijohet komunikimi ndërmjet udhëheqësve dhe të punësuarve në mënyrë që të punësuarit të njihen me qëllimet e punës, rezultatet dhe ndikimet/efektet që priten, si dhe se si projektet dhe aktivitetet e tyre kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të punës së institucionit.

Është krijuar komunikim i rregullt ndërmjet niveleve më të larta të udhëheqësisë dhe udhëheqësve të tjerë. Udhëheqësit e institucioneve kompetente nuk informohen rregullisht për qëllimet e punës, rezultatet dhe efektet e pritshme, gjë që vërehet nga fakti se në mbledhjet e nivelit më të lartë të udhëheqësisë, kryesisht në ministri, pjesëmarrja e udhëheqësve të organeve në përbërje zvogëlohet (për -3.2 pikë përqindje). Situata është e ngjashme edhe me përfshirjen e linjës së dytë të shfrytëzuesve buxhetorë, si dhe ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi shtetërore në kompetencën e tyre.

Në vitin 2020 ka pasur përmirësime minimale krahasuar me vitin paraprak për sa i përket diskutimit të qëllimeve strategjike (për 1.8 pikë përqindje), rreziqeve kryesore gjatë punës (për 1.4 pikë përqindje) dhe zbatimit të planit/buxhetit financiar (për 3.2 pikë përqindje).

Tabela 3: Rezultatet nga sfera “Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit”

Udhëheqja dhe stili i menaxhimit	Viti 2020							
	Niveli qendror		Nivel lokali		Gjithsej		2019	+/- 2020-2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Nu mër	%	Numë r	%	Numë r	%		
Mbajtja e takimeve të rregullta në nivel më të lartë të udhëheqësisë (kolegjiume)	80	93	56	90,3	136	91,9	90,8	1,1
Në takimet e nivelit më të lartë të udhëheqësisë diskutohet për:								
a) qëllimet strategjike	84	97,7	52	83,9	136	91,9	90,1	1,8
b) zbatimin e programeve/projekteve dhe arritjen e rezultateve	84	97,7	56	90,3	140	94,6	93,6	1
c) rreziqet kryesore gjatë punës	78	90,7	50	80,7	128	86,5	85,1	1,4
ç) realizimin e planit/buxhetit financiar	83	96,5	55	88,7	138	93,2	90	3,2
Në takimet e nivelit më të lartë të udhëheqësisë marrin pjesë edhe udhëheqësit e organeve në kuadër të shfrytëzuesit buxhetor.	28	32,6	45	72,6	73	49,3	52,5	-3,2

c) Qasja e planifikuar ndaj punës

Misioni dhe vizioni i institucioneve përcaktohen dhe publikohen në ueb faqen e secilit prej institucioneve, por nuk përditësohen dhe përmirësohen, ndërsa qëllimet e punës së institucionit nuk përcaktohen si qëllime strategjike, programore dhe operative, sipas të cilave:

- Qëllimet strategjike përfshihen në dokumentet e planifikimit strategjik dhe përcaktohen në mënyrë që ato të jenë konkrete, të matshme dhe të përcaktuara në kohë, me tregues të përcaktuar të rezultateve dhe ndikimeve/efekteve;
- Qëllimet e programeve përfshihen në arsyetimin e programeve të përcaktuara nga buxheti, përkatësisht plani financiar dhe kanë tregues të rezultateve dhe ndikimeve/efekteve;
- Qëllimet operative përfshihen në planet operative (plani vjetor i punës, plani i prokurimit publik, plani i punësimit, plani i investimeve, plani i mirëmbajtjes aktuale dhe investuese, plani i realizimit të projekteve etj.), në të cilat përcaktohen mjetet për realizimin e tyre.

Institucionet ende kanë probleme në harmonizimin e qëllimeve strategjike, programore dhe operacionale, ndërsa institucionet kompetente (organet në përbërje, shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore) rrallë njihen me qëllimet strategjike dhe programore të institucionit kompetent dhe nuk përfshihen në realizimin e tyre dhe njëkohësisht në kuadër të planeve të tyre operative, jo gjithmonë sigurojnë harmonizim me qëllimet strategjike dhe programore të institucionit kompetent.

Nevojitet përfshirje më e madhe e linjës së dytë të shfrytëzuesve buxhetorë në përgatitjen e dokumenteve strategjike.

Tabela 4: Rezultatet nga zona "Qasja e planifikuar ndaj punës"

Qasja e planifikuar ndaj punës	Viti 2020							
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej		2019	+/- 2020-2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë dhe		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numër	%	Num ër	%	Numë r	%		
Vizioni dhe misioni i përcaktuar i institucionit	83	96,5	42	67,7	125	84,5	85	-0,5
Qëllimet e përcaktuara strategjike	83	96,5	52	83,9	135	91,2	91,5	-0,3
Programet e përcaktuara	75	87,2	57	91,9	132	89,2	90	-0,8
Qëllimet e përcaktuara të programeve	75	87,2	56	90,3	131	88,5	88,6	-0,1
Qëllimet e programeve lidhen me qëllimet strategjike	75	87,2	53	85,5	128	86,5	87	-0,5
Plani i miratuar vjetor/programi i punës	73	84,9	46	74,2	119	80,4	81,6	-1,2

Në planin/programin vjetor të punës përcaktohen qëllimet që çdo njësi organizative duhet t'i arrijë gjatë vitit	70	81,4	43	69,4	113	76,3	73	3,3
Qëllimet e planeve/programeve vjetore të punës lidhen dhe harmonizohen me qëllimet strategjike	74	86	45	72,6	119	80,4	80	0,4
Në dokumentet e planifikimit në të cilat janë cekur të dhënat për qëllimet, përfshijnë të dhëna për mjetet e vlerësuara financiare të nevojshme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara.	71	82,6	42	67,7	113	76,3	75,9	0,4
Përcakton treguesit e suksesshmërisë përmes së cilëve monitorohet zbatimi i qëllimeve të përcaktuara.	66	76,7	23	37,1	89	60	60	0
Në përgatitjen e dokumenteve strategjike është përfshirë edhe linja e dytë e shfrytëzuesve buxhetorë të buxhetit	11	12,8	34	54,8	45	30,4	35,5	-5,1

c) Struktura organizative, autorizimet, përgjegjësitë dhe sistemi i raportimit

Struktura e brendshme organizative është në përputhje me kornizën rregullatore dhe në shumicën e rasteve mundëson ndarje të qartë të autorizimeve dhe përgjegjësi për zbatimin e kompetencave dhe qëllimeve të punës së subjekteve të sektorit publik. Vështirësi ekzistojnë në ndarjen e autorizimeve dhe përgjegjësi për zbatimin e mbikëqyrjes së institucioneve kompetente.

Struktura e brendshme organizative rregullohet me dispozita, statut ose rregullore për organizimin e brendshëm, ndërsa me aktin për sistematizim dhe aktvendime të përgjithshme rregullohen kompetencat dhe përgjegjësitë e udhëheqësve të njësive organizative për zbatimin e qëllimeve dhe menaxhimin e mjeteve financiare që u janë caktuar për arritjen e qëllimeve, autorizimeve dhe përgjegjësisë për realizimin e projekteve që përfshijnë disa njësi organizative dhe/ose institucione kompetente.

Ndarja e autorizimeve dhe përgjegjësi në shpenzimin e mjeteve buxhetore të miratuara sigurohet me miratimin e aktvendimit për shpërndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar dhe aktvendimeve për dhënien e autorizimeve të përgjithshme për ndërmarrjen e detyrimeve financiare dhe autorizimin e përgjithshëm për pagesën e udhëheqësit të njësisë për çështje financiare.

Vendime për shpërndarje të brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar kanë 80% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 69% të komunave dhe Qytetit të Shkupit. Vendime për autorizime të përgjithshme kanë 55% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror, që është 1 pikë përqindje më shumë në krahasim me vitin 2019 dhe 39% të komunave dhe qytetit të Shkupit.

Nevojiten përpjekje shtesë për të vendosur linja të qarta të raportimit, të cilat do t'u mundësojnë udhëheqësve që të monitorojnë realizimin e qëllimeve të punës, mjeteve të

alokuara financiare, rezultateve dhe ndikimeve dhe veçanërisht monitorimin e punës së institucioneve kompetente.

Tabela 5: Rezultate nga sfera e “Strukturës organizative, autorizimeve, përgjegjësi dhe sistemit të raportimit”

STRUKTURA ORGANIZATIVE, AUTORIZIMET, PËRGJEGJËSITË DHE SISTEMI I NJOFTIMIT	Viti 2020							
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej		2019	+/- 2020- 2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqin dje
	Numë r	%	Num ër	%	Numë r	%		
Kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të qartë të njësive organizative gjatë procesit të planifikimit strategjik	78	90,7	38	61,3	116	78,4	75	3,4
Autorizime dhe përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të qartë për arritjen e qëllimeve të dakorduara të programit/projektit/aktivitetit	73	84,9	43	69,4	116	78,4	77	1,4
Punët lidhur me koordinimin e zhvillimit të menaxhimit dhe kontrollit financiar janë në kompetencë të njësive për çështje financiare	66	76,7	47	75,8	113	76,4	78	-1,6
Në njësitë organizative/organet e tjera, në përbërjen e tyre janë vendosur vendet e punës lidhur me financat	17	19,8	13	21	30	20,3	21,3	-1
Udhëheqësit e njësive organizative kanë autorizim për menaxhim me mjetet buxhetore që janë të miratuara për realizimin e aktiviteteve në kompetencat e tyre	52	60,5	38	61,3	90	60,8	62,4	-1,6
Udhëheqësia më e lartë ka vendosur linja raportuese mbi arritjen e qëllimeve dhe lidhur me realizimin e buxhetit/planit financiar (qëllime të arritura, mjete buxhetore të shpenzuara, të ardhura të realizuara, detyrime të krijuara etj.)	69	80,2	51	82,3	120	81,1	80,1	1
Организационите единици изготвуваат извештаи за реализацијата на целите, програмите, проектите/ Njësitë organizative përpilojnë raporte për realizimin e qëllimeve, programeve, projekteve	70	81,4	52	83,9	122	82,4	84,4	-2

Njësitë organizative përgatisin raporte për realizimin e buxhetit të miratuar (mjete buxhetore të shpenzuara për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve, të ardhurave, detyrimeve kontraktuese, etj.)	46	53,5	50	80,7	96	64,9	65,2	-0,3
--	----	------	----	------	----	------	------	------

d) Menaxhim me burimet njerëzore

Në subjektet e sektorit publik gjatë punësimit, në aktet e sistematizimit janë përcaktuar kushte profesionale, siç janë: shkalla e arsimit, përvoja e punës, trajnime të tjera dhe aftësitë individuale që shfrytëzohen gjatë përzgjedhjes së të punësuarve të rinj.

Në përshkrimin e vendit të punës, në aktin e sistematizimit për çdo të punësuar janë përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësitë. Në nivel vjetor zbatohen aktivitete lidhur me planifikimin e numrit të të punësuarve dhe punësimeve, ndërsa vlerësimi i punës dhe efektiviteti/efikasiteti i të punësuarve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht.

Janë të domosdoshme përpjekje të mëtejshme për përpilimin e planve për përsosje profesionale dhe zbatim të aktiviteteve lidhur me përmirësimin e aftësive të nevojshme të të punësuarve për përmirësimin e efikasiteti/efektivitetit.³ Me themelimin e Akademisë së Financave Publike do të ndërmerren masa shtesë për realizimin e trajnimeve ku do të sigurohet mirëkuptim dhe do të vepohet sipas ligjeve, rregullave, akteve të tjera të brendshme si dhe procedurave që i përdorin institucionet për t'i zvogëluar gabimet, parregullsitë dhe shfrytëzimin ekonomik, efikas dhe efektiv të mjeteve.

Përmirësimi i gjendjes nevojitet në:

- Planet vjetore lidhur me punën e njësive organizative në drejtim të ndarjes së detyrave/aktiviteteve veçmas për çdo të punësuar⁴,
- procesin për përcaktimin e kategorive të ndjeshme të vendeve të punës, që gjatë kryerjes së punës, të punësuarit mund të jenë të ekspozuar në situata të ndërlikuara që mund të kenë ndikim negativ në punë,
- përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e anëtarëve të ekipeve të projekteve, si dhe aktivitetet dhe përgjegjësitë e tyre.

Tabela 6: Rezultate nga sfera “Zhvillimi i burimeve njerëzore”

	Viti 2020				+/-

³ Rezultatet e analizës tregojnë se 89.9% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal përgatisin plane trajnimi për të punësuarit në lidhje me realizimin e punës së tyre, që është 2.3 pikë përqindje më pak se në vitin 2019.

Zhvillimi i burimeve njerëzore (planifikimi i punës dhe monitorimi i suksesshmërisë nga rezultatet e arritura)	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej		2019	2020-2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqin dje
	Numër	%	Nu mër	%	Nu mër	%		
Ekzistojnë plane për trajnimin e të punësuarve lidhur me kryerjen e punës në fushëveprimin e tyre.	77	89,5	56	90,3	133	89,9	92,2	-2,3
Mbahet evidencë/regjistër për trajnim veçmas për çdo punëtor	71	82,6	40	64,5	111	75	75,9	-0,9
Të punësuarit janë drejtuar për trajnim lidhur me menaxhimin dhe kontrollin financiar (duke përfshirë trajnime në sferën e planifikimit strategjik, përpilimit dhe përgatitjes së kërkesës buxhetore, menaxhimit me rreziqe, furnizimit dhe lidhjes së marrëveshjeve, sistemeve kontabiliste, parregullsisve dhe mashtrimeve, etj.)	75	87,2	56	90,3	131	88,5	87,9	0,6
Në planet vjetore të punës së njësive organizative caktohen detyra/aktivitete veçmas për çdo punëtor.	36	41,9	21	34	57	38,5	39	-0,5

B. MENAXHIM ME RREZIQE

Në nivel qendror, rreth 70% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë dorëzuar Stretegi për menaxhim me rreziqe, rreth 74% e shfrytëzuesve buxhetorë i dokumentojnë rreziqet gjatë punës në regjistrin e rreziqeve, ndërsa rreth 67% i dokumentojnë në dokumentet e tyre të planifikimit.

Në nivel lokal, rreth 46% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë dorëzuar Stretegi për menaxhim me rreziqe, rreth 40% i dokumentojnë rreziqet gjatë punës në regjistrin e rreziqeve, ndërsa rreth 41,9% i dokumentojnë në dokumentet e tyre të planifikimit.

Në nivel qendror 59.3% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë caktuar person që është përgjegjës për koordinimin e procesit për menaxhim me rreziqe në nivel institucional, ndërsa 38.4% prej tyre kanë caktuar koordinator për rreziqe sipas njësive organizative. Në nivel lokal, rreth 24% e komunave kanë caktuar person që është përgjegjës për koordinimin e procesit për menaxhim me rreziqe në nivel institucional, ndërsa rreth 8% prej tyre kanë caktuar koordinator për rreziqe sipas njësive organizative.

Tek shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, ende nuk është zhvilluar praktika e konstatimit të rreziqeve sa i përket qëllimeve strategjike, operative dhe programeve, gjegjësisht të marren parasysh faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, përkatësisht ndryshimet në strukturën e brendshme dhe të jashtme të institucionit dhe institucioneve kompetente. Shfrytëzuesit në fjalë, më shumë përqendrohen në vlerësimin e rrezikut lidhur me harmonizimin (rregullsinë) e punës, ndërsa më pak në rreziqet që ndikojnë në rezultatet e punës së tyre.

Vlerësimi i rreziqeve bëhet në atë mënyrë që vlerësohet mundësia e paraqitjes dhe ndikimit të tyre. Masat dhe personat përgjegjës janë përcaktuar sa i përket të vepruarit pas konstatimit të rreziqeve dhe realizimit të masave.⁵

Nevojitet përmirësimi i mënyrës së dokumentimit të rreziqeve në regjistrin e rreziqeve, si dhe sistemit për raportim lidhur me rreziqet e konstatuara dhe zbatimin e masave për zvogëlimin e tyre në atë mënyrë që personi përgjegjës i institucionit do të informohet me kohë për rreziqet më të konsiderueshme të institucionit dhe institucioneve kompetente.⁶

Gjatë konstatimit të rreziqeve ende nuk shqyrtohen format e ndryshme të mashtrimeve, siç janë falsifikimi i dokumenteve, dhënia e informacioneve të pasakta për gjendjen financiare dhe suksesshmërinë sa i përket plotësimit të qëllimeve të caktuara, marrëveshjet dhe faturat fiktive, dhënia e ryshfetit, etj.

Shtojca nr.2 Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar Strategjinë për menaxhim me rreziqe)

Shtojca nr.3 Shqyrtim lidhur me frytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë përgatitur Regjistër të rreziqeve)

Tabela 7: Rezultate të komponentit “Menaxhim me rreziqe”

Menaxhim me rreziqe	Viti 2020							
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej		2019	+/- 2020-2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numër	%	Numër	%	Numër	%		
Konstatohen rreziqet që mund të ndikojnë në realizimin e:								
a) qëllimeve strategjike	68	79,1	37	59,7	105	70,9	72,3	-1,4
b) qëllimet e programit/projektit/aktivitetit	63	73,3	39	62,9	102	68,9	70,9	-2
c) qëllimet e përfshira në programin vjetor	55	63,9	35	56,5	90	60,8	61,7	-0,9
Ризиците се наведени во писмена форма во/ Rreziqet janë shënuar në formë të shkruar në:								
a) dokumentet e planifikimit (dokumente strategjike/plani i programeve zhvillimore/planet	58	67,4	26	41,9	84	56,8	63,1	-6,3

⁵ Në nivel qendror, 59.3% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë emëruar person përgjegjës për koordinimin e procesit sa i përket menaxhimit me rreziqet në nivel institucional dhe 38.4% e tyre kanë emëruar koordinatorë për rreziqet sipas njësive organizative. Në nivel lokal, rreth 24% e komunave kanë emëruar person përgjegjës për koordinimin e procesit të menaxhimit me rreziqet në nivel institucional dhe rreth 8% e tyre kanë emëruar koordinatorë për rreziqet sipas njësive organizative.

⁶ Vetëm rreth 14% e shfrytëzuesve buxhetorë nga niveli qendror marrin informacione nga organet në përbërje dhe linja e dytë e shfrytëzuesve buxhetorë për rreziqet më të konsiderueshme. Kjo përqindje është më e lartë në nivel lokal dhe është rreth 31%.

vjetore të punësimit)								
b) në regjistrin e rreziqeve, të konstatuara sipas udhëzimeve për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqe të shfrytëzuesit buxhetorë	64	74,4	25	40,3	89	60,1	58,9	1,2
Sa i përket rreziqeve të konstatuara vlerësohet mundësia dhe ndikimi i rreziqeve në fjalë	64	74,4	34	54,8	98	66,2	65,9	0,3
Është vendosur sistem për raportim sa i përket rreziqeve më të konsiderueshme	49	57	17	27,4	66	44,6	41,8	2,8
Është përcaktuar person përgjegjës për koordinim të vendosjes së një procesi për menaxhim me rreziqe	51	59,3	15	24,2	66	44,6	41,8	2,8
Janë përcaktuar koordinatorë lidhur me rreziqet në njësi organizative	33	38,4	5	8,1	38	25,7	23,4	2,3
Shfrytëzuesit buxhetorë në kuadër të buxhetit raportojnë lidhur me rreziqet kryesore	12	13,9	19	30,7	31	20,9	23,4	-2,5

B.KONTROLLI

Shfrytëzuesit buxhetorë në nivel lokal dhe qendror në shumicën e proceseve⁷ më të rëndësishme të punës kanë miratuar rrugulla të përcaktuara, gjegjësisht akte të brendshme (udhëzime) me të cilat, në bazë të ligjeve dhe rregullave të tjera, në mënyrë më të hollësishme caktohen rregullat e të vepruarit, definohen pjesëmarrësit, autorizimet dhe përgjegjësitë e tyre, aktivitetet e kontrollit, duke përfshirë edhe kontrollin paraprak shtesë dhe përcaktohen formularë.

Proceduarat janë në dispozicion të udhëheqësve dhe të punësuarve, si dhe përditësohen varësisht nga ndryshimet e ligjeve dhe rregulloreve të tjera mbi të cilat ato bazohen, nga ndryshimet në punën e institucionit dhe institucioneve kompetente, si dhe nga rezultate të vlerësimit të jashtëm lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Sipas analizës së të dhënave lidhur me kontrollin, theksohet se në krahasim me vitin 2019, vërehet përmirësim sa i përket pjesës së rregullimit të procedurës së zbatimit të kontrollit shtesë (ex post) përmes procedurave të përcaktuara për 3.2 pikë përqindje.

Përqindja e procedurave të brendshme të përcaktuara është ende e vogël që përfshijnë udhëzime për mënyrën e bashkëpunimit dhe aktivitetet e shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së dytë dhe njohuritë lidhur me atë se në çfarë mase, shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë i kanë rregulluar aktivitetet e kontrollit në proceset e përgatitjes dhe realizimit të planeve/buxheteve financiare, prokurimeve dhe marrëveshjeve, menaxhimit me pronë, etj.

Kryesisht (në 73% të institucioneve) zbatohet parimi “ndarja detyrimeve”, me ç’rast asnjë individ nuk njëkohësisht nuk është përgjegjës për iniciimin, miratimin dhe evidentimin e transaksioneve, pagesës, harmonizimin dhe shqyrtimin e raporteve.

⁷ Proceset që kanë të bëjnë me planifikimin, programimin, realizimin e buxhetit, p.sh. planin financiar, prokurimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve, evidentimin e ngjarjeve dhe transaksioneve të punës, menaxhimin e pronës (materiale dhe të jomateriale), menaxhimin e projekteve, arkëtimin e të hyrave vetanake, kthimin e mjeteve të shpenzuara në mënyrë të padrejtë ose të paguara gabimisht.

Në raste kur nuk mund të zbatohet parimi “ndarja e detyrimeve”, për shkak të numrit të kufizuar të të punësuarve, udhëheqësit përcaktojnë masa të tjera që të zvogëlohet mundësia e ekspozimit të një personi në rrezik, me qëllim që të jetë në gjendje të bëjë dhe të fsheh gabime, parregullsi dhe mashtrime gjatë kryerjes së detyrimeve të tij.

Transaksionet dhe ngjarjet afariste që kanë ndikim financiar realizohen, pasi që të jetë kryer vlerësimi i ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksionit të propozuar, disponueshmëria e mjeteve financiare, dobishmëria ekonomike dhe miratimi i personit të autorizuar. Parimi i nënshkrimit të dyfishtë kryesisht është zbatuar në të gjitha transaksionet financiare dhe aktivitetet që kanë ndikim financiar. Procedurat e miratimit zakonisht zbatohen sipas nevojës dhe detyrimit të paraqitur dhe realizimit të pagesave.

Udhëheqësit në vazhdimësi ndjekin realizimin e qëllimeve të punës dhe detyrat e të punësuarve me qëllim që të sigurohet kryerje e punës në mënyrë efektive dhe efikase.

Përmirësimi i gjendjes nevojitet në:

- zbatimin e procedurave për monitorimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim që të sigurohet se kontrolli bëhet siç është planifikuar dhe se përditësohet sipas ndryshimeve në punë dhe kushteve të mjedisit,
- evidentimin e mangësive gjatë kontrollit, gjegjësisht ngjarjeve të padëshiruara që pamundësojnë realizimin e qëllimeve të punës së institucionit, siç është heqja e mangësive,
- zbatimin e kontrollit shtesë të pagesave të destinuara dhe shfrytëzimit të donacioneve, transfereve, ndihmës, subvencioneve për shfrytëzuesit përfundimtarë, me qëllim që të kontrollohet nëse mjetet financiare të ndara janë shfrytëzuar sipas destinimit ose në të kundërtën sigurohet kthimi i mjeteve të shfrytëzuara pa destinim dhe
- përforcimin e kontrollit shtesë në formën e kontrollit administrativ dhe inspektues.

Në procedurat (aktet e brendshme), përjashtimet në procedurë nuk arsyetohen, dokumentohen dhe evidentohen para dorëzimit të tyre për miratim dhe ato nuk miratohen nga niveli i lartë para realizimit të tyre. Përjashtimet e procedurave të përcaktuara nuk analizohen që të mund të përcaktohen rrethanat se përse ka arritur deri në devijim dhe nuk përcaktohen masat për mënjanimin e tyre, me ç'rast do të kishte konkluzione për mënyrën e të vepruarit, planifikim e aktiviteteve të ardhshme ose ripërgatitje të procedurave.

Te shfrytëzuesit buxhetorë, kryesisht është përcaktuar mënyra e të vepruarit në aspekt të sigurimit të vazhdimësisë në punë është vendosur procesi i menaxhimit me pajisje dhe janë përcaktuar aktivitetet e kontrollit lidhur me infrastrukturën informatike që i referohen mbrojtjes fizike dhe të drejtës së qasjes, mirëmbajtjes së harduerit dhe softuerit, përpunimit të kopjeve të sigurisë, menaxhimit me llogaritë e shfrytëzuesve, sigurimit të nivelit të nevojshëm për furnizim dhe sigurim të të dhënave.

Zbatohen masa përkatëse për mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtje në punë, sigurohet zëvendësim në rast të mungesës së përkohshme të të punësuarve dhe gjithashtu sigurohet arkëtimi i kërkesave, realizmi i mirë i punëve të dakorduara ose detyrimeve të tjera që dalin nga marrëveshja.

Përmirësimi i gjendjes nevojitet në vlerësimin e ndikimin eventual gjatë miratimit të rregulloreve të reja, ndryshimin e rregulloreve ekzistuese, ndryshimin e përgjegjësive në punë dhe vendosjen e teknologjisë së re.

Varësisht nga lloji i pronës dhe informacioneve, si dhe rreziku i vlerësuar lidhur me humbjen e mundshme, keqpërdorimi dhe tjetërsimi i paautorizuar i mundshëm, në të shumtën e rasteve përcaktohen kufizime për qasje në mjete dhe informacione dhe gjithashtu zbatohet regjistrimi i pronës dhe detyrimeve.

Tabela 8: Rezultate nga komponenti “Kontrolli”

KONTROLLI	Viti 2020							
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej		2019	+/- 2020-2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numër	%	Nu mër	%	Nu mër	%		
Ekzistojnë procedura të brendshme të përcaktuara (rregullore, udhëzime, etj.) të cilat si vazhdimësi e rregulloreve i përcaktojnë proceset në vijim:								
a) procesi i përgatitjes dhe realizimit të planit strategjik	46	53,5	25	40,3	71	48	45,4	2,6
b) procesi i përgatitjes dhe realizimit të kërkesës buxhetore/propozim buxhetit	69	80,2	46	74,2	115	77,7	74,5	3,2
c) procesi i evidentimit të ngjarjeve afariste dhe transkacioneve	69	80,2	39	62,9	108	73	68,1	4,9
ç) procesi i prokurimeve dhe marrëveshjes	72	83,7	43	69,4	115	77,7	75,9	1,8
d) procesi i menaxhimit me pronë – mjete materiale dhe jomateriale	52	60,5	28	45,2	80	54	53,9	0,1
dh) procesi i arkëtimit të të ardhurave vetanake	23	26,7	38	61,3	61	41,2	43,3	-2,1
e) procesi i kthimit të mjeteve të shpenzuara në mënyrë të pajustificueshme ose të paguara gabimisht	35	40,7	30	48,4	65	43,9	42,5	1,4
Procedurat e brendshme përditësohen	70	81,4	41	66	111	75	74,5	0,5
Është siguruar zbatimi i parimit të ndarjes së detyrimeve sipas ligjit dhe standardeve, gjegjësisht personi i njëjtë të mos jetë përgjegjës për miratim, realizim, kontabilitet dhe kontroll	69	80,2	39	62,9	108	73	73	0
Realizohet kontroll shtesë për shpenzim të destinuar të mjeteve buxhetore të paguara (p.sh.kontroll në vendngjarje për subvencione të paguara, grante, ndihmë, kompensime të ndryshme, mjete buxhetore transferuese sipas shfrytëzuesve përfundimtarë, etj.)	49	57	38	61,3	87	58,8	58,2	0,6

Procedura për realizimin e kontrollit shtesë është rregulluar përmes procedurave të përcaktuara	40	46,5	12	19,4	52	35,1	31,9	3,2
Procedura për realizimin e kontrollit shtesë së shpenzimeve të dedikuara të mjeteve të paguara buxhetore është:								
a) një pjesë e punës së rregullt të njësive organizative në institucionet përgjegjëse për këtë	56	65,1	36	58,1	92	62,2	61,7	0,5
b) Detyrë Ad Hok në raste kur do të paraqitet nevoja për kontroll shtesë (psh. "në rast të Kallëzimeve anonime sa i përket mundësisë për shfrytëzimin e parrgullt të mjeteve buxhetore)	47	54,6	27	43,6	74	50	52,5	-2,5
Procedurat e brendshme të përcaktuara që i referohen përgatitjes dhe realizimit të planeve strategjike, përgatitjes dhe realizimit të planit/buxhetit financiar, prokurimeve dhe marrëveshjeve, kontrollit shtesë dhe etj., përmbajnë udhëzime për mënyrën e bashkëpunimit dhe aktiviteteve të shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së dytë.	9	10,5	18	29	27	18,2	19,1	-0,9
Ekzistojnë njohuri se në çfarë mase shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë i kanë rregulluar aktivitetet e kontrollit në proceset e përgatitjes dhe realizimit të planeve/buxheteve financiare, prokurimeve dhe marrëveshjeve, menaxhimit me pronë, etj.	4	4,6	16	25,8	20	13,5	14,2	-0,7

Ç. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Tek shfrytëzuesit buxhetorë, kryesisht ende nuk është vendosur sistem i brendshëm i amortizuar për raportim me të cilin sigurohen të dhëna dhe informacione të plota, me kohë dhe të sakta, si dhe për shkëmbimin e tyre ndërmjet njësive organizative të brendshme për nevojat e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, zbatimit të programeve, projekteve dhe aktiviteteve, si dhe monitorimit të realizimit të qëllimeve të punës dhe mjeteve të shpenzuara financiare.

Ende nuk janë zhvilluar sisteme kontabiliste të amortizuara që do të përshijnë kontabilitet të kostos dhe menaxhimit, sistemeve të tjera të evidencës, bazave të të dhënave të qëllimeve, rreziqeve dhe informacioneve tjera financiare dhe jofinanciare varësisht nga nevojat dhe specifikat e punës.

Është përcaktuar procesi i menaxhimit të dokumenteve dhe ruajtjes së tyre sipas kornizës ligjore dhe akteve të brendshme, por nuk janë zhvilluar sistemet që do të mundësojnë shkëmbimin e informacioneve ndërmjet institucioneve dhe institucioneve kompetente.

Kryesisht është vendosur sistem i komunikimit me qytetarët, gjegjësisht me shfrytëzuesit e shërbimeve përmes së cilit mund të japim propozime për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, është përgatitur dhe zbatohet procedura e parashtrimit të ankesave dhe parashtrësive. Ekziston adresë kontakti për kallëzime anonime të parregullsive, ankesave, etj., si dhe gjithashtu është emëruar një person përgjegjës për parregullsitë. Është përcaktuar mënyra e të vepruarit lidhur me parregullsitë e kallëzuara dhe raportimet sa i përket parregullsive të konstatuara në punë. Të punësuarit në institucion dhe institucionet kompetente janë të njoftuar me mënyrën e të vepruarit në rast të parregullsive të konstatuara.

Tabela 9: Rezultate nga komponenti "Informacioni dhe komunikimi"

INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI	Viti 2020							
	Niveli qendror		Niveli lokal		/ Gjithsej		2019	+/- 2020- 2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindj e
	Num ër	%	Num ër	%	Nu mër	%		
Janë përcaktuar linja raportuese përkatëse për arritjen e qëllimeve strategjike të përfshira në dokumentet strategjike	54	62,8	25	40,3	79	53,4	50,3	3,1
Është vendosur sistem për informim lidhur me realizimin e të programeve/projekteve	65	75,6	44	71	109	73,6	72,3	1,3
Është vendosur sistem i rregullt i monitorimit dhe analizimit të realizimit të planit/buxhetit financiar	81	94,2	57	91,9	138	93,2	93,6	-0,4
Njësite organizative marrin pjesë në përgatitjen e planit/buxhetit financiar	75	87,2	57	91,9	132	89,2	88,6	0,6
Njësitë organizative marrin informacione për mjetet buxhetore të miratuara për zbatimin e programeve/projekteve/aktiviteteve për të cilat janë kompetente	74	86	56	90,3	130	87,8	87,9	-0,1
Për nevojën e monitorimit të zbatimit të planit/buxhetit financiar është përpunuar më hollësisht klasifikimi ekonomik i përcaktuar në Rregulloren për planin e kontabilitetit/përlogaritjes së buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetorë, gjegjësisht nëse është hapur analizë e planit kontabilist	58	67,4	46	74,2	104	70,3	70,9	-0,6
Sistemet kontabiliste mundësojnë monitorimin e shpenzimeve/të ardhurave sipas:								
a) programeve	73	84,9	61	98,4	134	90,5	90	0,5
b) projekteve	51	59,3	46	74,2	97	65,5	67,4	-1,9
c)aktiviteteve	43	50	42	67,7	85	57,4	61	-3,6
ç) njësite organizative	44	51,2	37	59,7	81	54,7	56,7	-2
Nëse keni evidencë të centralizuar të të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara dhe detyrimeve kontaktuese dhe nëse mbështetet ajo në sistemin e informatikës	61	70,9	39	63	100	67,6	66	1,6
Përveç raporteve financiare të përcaktuara (bilanci i gjendjes, bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe bilanci i konsoliduar) ka edhe raporte të brendshme shtesë për nevojat e menaxhimit financiar (psh. Raporte për detyrime të papaguara sipas	64	74,4	48	77,4	112	75,7	70,2	5,5

programeve/projekteve/njësive organizative, raporte për detyrime kontraktuese por ende të pafaktuara, raporte për rezultatet e arritura të programeve/projekteve, etj.)								
Sistemet e punës (financa, prokurime dhe marrëveshje, evidenca materiale, kuadri, etj.) mbështeten mjaftueshëm nga teknologjia e informatikës (sistemi TI)	72	83,7	52	83,9	124	83,8	82,3	1,5
Sistemet TI që mbështesin procese të caktuara janë të integruara me njëra-tjetrën	46	53,5	31	50	77	52	50,3	1,7
Proceset kryesore të punës që zbatohen në kuadër të njësive organizative janë të dokumentuara, respektivisht nëse janë të përcaktuara në mënyrë të qartë procedurat, detyrat e pjesëmarrësve individualë, autorizimet dhe përgjegjësitë (psh. nëse ekzistojnë udhëzime të brendshme, rregullore, nëse janë përgatitur harta/libra të proceseve të punës, etj.)	68	79,1	39	62,9	107	72,3	71,6	0,7
Linja e dytë e shfrytëzuesve buxhetorë përgatisin edhe raporte të tjera përveç raporteve të përcaktuara financiare, që ia dorëzojnë shfrytëzuesit buxhetor të linjës së parë.	9	10,5	19	30,7	28	18,9	20,6	-1,7
Është realizuar lidhje e informatikës me linjën e dytë të shfrytëzuesve buxhetorë (psh. përmes sistemit të Thesarit, etj.)	12	13,9	42	67,7	54	36,5	39	-2,5

D. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SISTEMIT

Aktivitetet e monitorimit të vazhdueshëm realizohen gjatë punës dhe përfshijnë aktivitete të rregullta administrative dhe të kontrollit, si dhe aktivitete të tjera që të punësuarit i ndërmarrin gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Procesi i vetëvlerësimit zbatohet së paku një herë në vit sipas rregullave me të cilat përcaktohet Deklarata e cilësisë dhe gjendjes së kontrollit të brendshëm.

Nevojiten masa dhe aktivitete shtesë për rritjen e numrit të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, që përgatisin dhe realizojnë Plan për mënjanimin e mangësive dhe parregullsive dhe njëherit ndjekin realizimin e e tij në institucion dhe institucionet kompetente.

Rekomandimet zbatohen në revizionin e jashtëm, ndërsa pjesërisht monitorohet zbatimi i rekomandimeve të revizionit të jashtëm tek institucionet kompetente, por në rast se nuk zbatohen rekomandimet, personi përgjegjës i institucionit nuk ndërmerr masa përkatëse.

Tabela 10: Rezultate të komponentit "Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit"

	Viti 2020			2019	+/-
	Niveli qendror	Niveli lokal	Gjithsej		

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit								2020- 2019
	86 shfrytëzues buxhetorë		62 shfrytëzues buxhetorë		148 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqind je
	Numë r	%	Numër	%	Numër	%		
Udhëheqësit më të lartë kanë vendosur sistem për raportim që u mundëson marrje të raporteve lidhur me funksionimin e e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, për të cilat janë përgjegjës.	52	60,5	35	56,5	87	58,8	56	2,8
Janë vendosur procedura që sigurojnë akte të brendshme (rregullore, udhëzime dhe etj.) që zbatohen në praktikë dhe përditësohen	58	67,4	36	58,1	94	63,5	60,3	3,2
Zbatohen rekomandime të revizorëve të jashtëm	70	81,4	52	83,9	122	82,4	83,7	-1,3
Rekomandimet e revizionit të brendshëm zbatohen sipas planeve aksionale për zbatimin e rekomandimeve.	54	62,8	48	77,4	102	68,9	70,2	-1,3
Ekzistojnë sisteme përkatëse për raportim të vendosura nga shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë që sigurojnë monitorim të funksionimit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar tek shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë.	8	9,3	24	38,7	32	21,6	21,3	0,3

3. RAPORT PËR REVIZIONET DHE AKTIVITETET E KRYERA TË REVIZIONIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2020

3.1 GJENDJA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM SIPAS EVIDENCËS SË NJËSISË QENDRORE TË HARMONIZIMIT

3.1.1 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm tek subjektet e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal

Në përputhje me evidencën e Njesisë qendrore për harmonizim përfudimisht Më datë 31.12.2020 tek subjektet nga sektori publik në **nivel qendror** janë themeluar 91 njësi për revizion⁸ të brendshëm ku janë punësuar 136 revizorë të brendshëm, prej të cilëve 45 (rreth 33%) janë udhëheqës. Në vitin 2020 në raport me vitin e kaluar në nivel qendror numri i revizorëve të brendshëm është rritur për 8, kurse numri i udhëheqësve është zvogëluar për 5.

Tek shfrytëzuesit buxhetorë në **nivel lokal**, përfundimisht më datë 31.12.2020, janë themeluar 73 njësi për revizion⁹ të brendshëm ku janë punësuar 68 revizorë të brendshëm, prej të cilëve 18 (rreth 26%) janë udhëheqës. Në vitin 2020 në raport me vitin e kaluar në nivel lokal numri i revizorëve të brendshëm është rritur për një, kurse numri i udhëheqësve është zvogëluar për një.

Nga ajo që u theksua më lartë, mund të konstatojmë se në vitin 2020 në raport me vitin parapark në nivel qendror dhe lokal numri i përgjithshëm i revizorëve të brendshëm është rritur për 9 (6,7%), kurse numri i udhëheqësve është zvogëluar për 6 (8.6%). Kjo tendencë e zvogëlimit të numrit të udhëheqësve pritet që të vazhdojë edhe në vitet vijuese, para së gjithash për arsye të strukturës së moshës së tyre.

3.1.2 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm tek shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal

Nga 79 shfrytëzues buxhetorë nga **niveli qendror** që kanë kryer revizion të brendshëm, 63 (rreth 79%) kanë themeluar njësinë e tyre për revizion të brendshëm, 15 (rreth 19%) kanë nënshkruar Marrëveshje, kurse 2 (rreth 2%) njëkohësisht kanë themeluar njësinë e tyre për revizion të brendshëm dhe kanë nënshkruar marrëveshje.

Nga 65 njësitë e themeluara për revizion të brendshëm, 21 (32.3%) nuk janë ekipuar, 22 (35.4%) janë ekipuar me nga një revizor të brendshëm, kurse 22 (33.8%) me nga dy e më shumë revizorë. 16 shfrytëzuesit e tjerë buxhetor nga niveli qendror që nuk kanë kryer revizion të brendshëm janë 8 inspektorate, 4 komisione, 3 agjenci dhe Organi i revizorit të Instrumentit për ndihmë paraaderuese.

Nga 77 shfrytëzues buxhetorë në **nivel lokal** që kanë kryer revizion të brendshëm, 57 (rreth 74%) kanë themeluar njësinë e tyre për revizion të brendshëm, 10 (rreth 13%) kanë nënshkruar marrëveshje, kurse 10 (rreth 13%) njëkohësisht kanë themeluar njësinë e tyre për revizion të

⁸ <https://finance.gov.mk/%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%98%D0%B1%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%B2%D0%BD%D0%B0%D1%82%D1%80%D0%B5%D1%88%D0%BD%D0%B0-%D1%80%D0%B5%D0%B2/>

⁹ <https://finance.gov.mk/%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%98%D0%B1%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%B2%D0%BD%D0%B0%D1%82%D1%80%D0%B5%D1%88%D0%BD%D0%B0-%D1%80%D0%B5%D0%B2/>

brendshëm dhe kanë nënshkruar marrëveshje. Nga 67 njësitë e themeluara për revizion të brendshëm 31 (46,2%) nuk janë ekipuar, 24 (35.8%) janë ekipuar me nga një revizor të brendshëm, kurse 12 (18%) janë me nga 3 e më shumë revizorë. 4 komunat e tjera (Staro Nagoriçani, Studeniçani, Haraçina dhe Dollneni) nuk kanë kryer revizion të brendshëm.

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se përqindja e njësive të themeluara për revizion të brendshëm (në nivel qendror rreth 68%, kurse në nivel lokal 82%) që nuk janë ekipuar, gjegjësisht janë ekipuar me nga një revizor të brendshëm është e lartë. Me qëllim që të plotësohen kriteret minimale me nga dy revizorë për secilën njësi për revizion të brendshëm, në periudhën e ardhshme duhet të ndërmerren aktivitete për ekipimin e njësive për revizion të brendshëm.

Tabela nr 11: Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë nga linja e parë, fondet dhe komunat që kanë vendosur revizion të brendshëm

Shfrytëzues buxhetorë nga linja e parë, fondet dhe komunat	Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve buxhetorë (shfrytëzues buxhetorë nga linja e parë, fondet dhe komunat)	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë nga linja e parë fondet dhe komunat që kanë vendosur revizion të brendshëm deri në datë 31.12.2020				% e shfrytëzuesëve buxhetorë që deri në datë 31.12.2020 kanë vendosur revizion të brendshëm
		Njësia për revizion të brendshëm	Marrëveshje	Njësia për revizion të brendshëm dhe marrëveshje	Gjithsej	
Niveli qendror	96	63	15	2	80	83%
Niveli lokal	81	57	10	10	77	95%
Gjithsej	177	120	25	12	157	89 %

Revizioni i brendshëm është vendosur edhe në 36¹⁰ shfrytëzues buxhetorë të themeluar me ligj, bartës të autorizimeve publike dhe njësi shfrytëzuese (prej të cilave 30 në nivel qendror dhe 6 në nivel lokal).

Tabela nr. 12: Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u janë dhënë autorizime publike dhe njësitë shfrytëzuese që kanë vendosur revizion të brendshëm

Shfrytëzues buxhetorë të themeluar	Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u janë dhënë autorizime publike dhe njësitë shfrytëzues që kanë vendosur revizion të brendshëm deri në datë 31.12.2020	% e shfrytëzuesve buxhetorë që deri në datë 31.12.2020
------------------------------------	--------------------------------------	---	--

¹⁰ Për të cilat NJQH mban evidencë

me ligj të cilëve u janë dhënë autorizime publike dhe njësitë shfrytëzuese	buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u janë dhënë autorizime publike dhe njësitë shfrytëzuese për të cilat NJQH-ja mban evidencë	Njësia për revizion të brendshëm	Marrëveshje	Nuk ka njësi për revizion të brendshëm, ka revizor të brendshëm	Gjithsej	kanë vendosur revizion të brendshëm
Niveli qendror	30	26	0	4	30	100
Niveli lokal	6	6	0		6	100
Gjithsej	36	32	0	4	36	100

3.1.3 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm në ministri

Nga gjithsej 16 ministri, në njësitë për revizion të brendshëm në 4 ministri nuk ka të punësuar, në 3 ministri ka nga një të punësuar, kurse në 9 prej tyre nuk ka udhëheqës së njësive për revizion të brendshëm.

Kjo thekson faktin se në 56% të ministrive nuk janë plotësuar kushtet për punë të njësive për revizion të brendshëm.

Në 13 ministri, njësitë për revizion të brendshëm janë të organizuara si departamente (njësi).

Duke pasur parasysh se me Ligjin e ri për sistem të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, ministrinë do të kenë rolin e shfrytëzuesve buxhetorë amë që duhet të kryejnë revizion të brendshëm në organet e veta në përbërje, linja e dytë e shfrytëzuesve buxhetorë, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore nga kompetencat e tyre, nevojitet që të ndërmeren masa urgjente për riorganizimin e njësive për revizion të brendshëm dhe ekipimin e tyre.

Tabela nr.13: Organizimi dhe ekipimi i NJRB në ministri

Nr. r.	Institucionet	Numri i të punësuarve	Udhëheqësi i emruar	Forma e organizimit
--------	---------------	-----------------------	---------------------	---------------------

		në NJRB	(po/jo)	në NJKB
1.	Ministria e Financave	6	Po	Sektor
2.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së ujërave	4	Jo	Sektor
3.	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	4	Jo	Sektor
4.	Ministria e Mbrojtjes	4	Po	Njësi
5.	Ministrie e Punëve të Brendshme	2	Po	Njësi
6.	Ministria e Punëve të Jashtme	2	Po	Njësi
7.	Ministria e Shëndetësisë	1	Po	Njësi
8.	Ministria e Kulturës	0	Jo	Njësi
9.	Ministria e Drejtësisë	1	Jo	Njësi
10.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	3	Po	Njësi
11.	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	2	Jo	Njësi
12.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	2	Jo	Njësi
13.	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	1	Po	Njësi
14.	Ministria e Ekonomisë	0	Jo	Njësi
15.	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	0	Jo	Njësi
16.	Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive	0	Jo	Njësi

3.2 GJENDJA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM SIPAS RAPORTEVE TË DORËZUARA VJETORE PËR VITIN 2020

Detyrim për dorëzimin e raportit për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm kanë 176 shfrytëzues buxhetorë prej të cilëve 95 në nivel qendror dhe 81 në nivel lokal.

Nga gjithsej 176 shfrytëzues buxhetorë, raport dorëzuan 61%, përkatësisht 107¹¹ subjekte, kurse raport nuk dorëzuan 39%, përkatësisht 69¹² subjekte.

Përveç shfrytëzuesve buxhetorë, raport kanë dorëzuar 4 subjekte¹³ nga sektori publik në nivel qendror edhe pse nuk kanë detyrim për dorëzimin e tij. Me këtë, numri i raporteve të dorëzuara në nivel qendror është 65.

¹¹ 61 nga niveli qendror dhe 46 nga niveli lokal

¹² 34 nga niveli qendror dhe 35 nga niveli lokal

(Shtojca 4. Shqyrtim lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar raport për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm.

3.2.1 Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel qendror sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2020

Nga 65 shfrytëzues buxhetorë në nivel qendror të cilët kanë dorëzuar raport, 49 kanë themeluar njësi për revizion të brendshëm në të cilën janë sistemuar 262 vende të punës, kurse janë plotësuar 96, gjegjësisht 36.6%.


Në përputhje me Planet vjetore për vitin 2020, në nivel qendror planifikohet kryerja e revizionit të 221 (viti 2019 - 221), nga të cilat fillimisht janë planifikuar 200, kurse 21 janë revizione shtesë ad hoc me kërkesë të udhëheqësve.

Nga gjithsej 221 revizione të planifikuara janë kryer 142¹⁴, gjegjësisht 64.3%,¹⁵ që paraqet rënie prej 17.1%.

Në vitin 2020, fillimisht janë planifikuar 25 revizione lidhur me programet e BE-së¹⁶ dhe një revizion ad hoc, prej të cilëve janë kryer 18¹⁷ gjegjësisht 69%¹⁸ që paraqet rënie për 13%.

Sipas viteve, revizione të planifikuara dhe të kryera janë si në vijim:

Revizione të planifikuara dhe të kryera



Revizione të planifikuara

Revizione të kryera

Nga 142 revizione të kryera:

- 27.5% (39) janë revizione sistematike

¹³ Fondi për Sigurim të Depozitave, Drejtoria e Zbulimit Financiar, SHA EMV dhe Byroja e Prokurimeve Publike

¹⁴ Viti 2019 – 180 revizione

¹⁵ Viti 2019 – 81.4%

¹⁶ Viti 2019 - 27

¹⁷ Viti 2019 - 23

¹⁸ Viti 2019 – 82%

- rreth 39.4% (56) janë revizione të rregullshmërisë
- rreth 0.7% (1) janë revizione financiare
- rreth 1.4% (2) janë revizione të suksesshmërisë
- rreth 9.9% (14) janë revizione për monitorim të rekomandimeve
- rreth 20.4% (29) janë revizione të kombinuara dhe
- 0.7% (1) TI revizione.

Në vitin 2020, nga 2.2722 rekomandime (nga viti paraprak dhe rrjedhës me afat për maturim në vitin 2020) janë realizuar 1634, gjegjësisht 60% e rekomandimeve (në vitin 2019 - 66.1%).¹⁹

Në vitin 2020, për revizionet e kryera në nivel qendror janë dhënë 697 rekomandime, prej të cilave 488 janë me afat të kryerjes në vitin 2020, kurse janë kryer vetëm 254.

Nga 2.483 rekomandime nga raportet të viteve paraprake, në vitin 2020 janë realizuar 1380 rekomandime.²⁰

Njësitë për revizion të brendshëm në nivel qendro në vitin 2020 kanë kryer 142 revizione (në vitin 2019 - 180) për të cilat kanë shpenzuar 11.325 ditë lidhur me revizionin (në vitin 2019 - 14.658), përkatësisht 80 ditë lidhur me revizionin (në vitin 2019 - 84) mesatarisht, që është 4 ditë më pak se viti i kaluar.

Ditët e nevojshme të revizionit për një revizion sipas viteve



3.2.2 Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel lokal sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2020

¹⁹ E përlogaritur duke aplikuar treguesin “passport” – “Përqindja e rekomandimeve të zbatuara të revizionit të brendshëm”

²⁰ Për 249 rekomandime nga vitet paraprake dhe 179 nga viti 2020, nuk ka maturuar afati i realizimit.


Nga 81 subjekte në nivel lokal që kanë detyrim për dorëzim të raportit për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm në nivel lokal, raport kanë dorëzuar 46 komuna (në vitin 2019 - 52).

Nga 46 subjekte në nivel lokal që kanë dorëzuar raport, 33 kanë themeluar njësi për revizion të brendshëm, në të cilat janë sistemuar 93 vende të punës, kurse janë plotësuar 51, gjegjësisht rreth 55%.

Në përputhje me Planet vjetore për vitin 2020, në nivel lokal planifikohet kryerja e 172 revizioneve prej të cilave 164 fillimisht janë planifikuar dhe 8 revizione ad hoc me kërkesë të udhëheqësve,²¹ ndërsa prej tyre janë kryer 113 revizione²², gjegjësisht rreth 66%.²³

Në vitin 2020 është kryer një revizion lidhur me programet e BE-së edhe pse vetëm 16 komuna²⁴ informuan se shfrytëzojnë mjete nga fondet e BE-së.

Sipas viteve, revizione të planifikuara dhe të kryera janë si në vijim:



Nga 113 revizione të kryera

- rreth 17.7% (20) janë revizione sistemtike,
- rreth 65.5% (74) janë revizione të rregullshmërisë,
- 4.4% (5) janë revizione të sukseshmërisë,
- rreth 6% (7) janë revizione financiare,
- rreth 5.3 (6) janë revizione për monitorim të rekomandimeve, rreth 0.8% (1) janë revizione të kombinuara.

²¹ Në vitin 2019 - 194

²² Në vitin 2019 - 161

²³ Në vitin 2019 – 83%

²⁴ Në vitin 2019 - 17

Në vitin 2020, nga 1.833 rekomandime (nga viti paraprak dhe viti rrjedhës me afat të maturimit në vitin 2020) janë realizuar 1070, gjegjësisht 58.4% e rekomandimeve (në vitin 2018 – 57.8%)²⁵

Në vitin 2020, për revizionet e kryera në nivel qendror janë dhënë 637 rekomandime prej të cilave 450 janë me afat të kryerjes në vitin 2020, kurse janë kryer 239.

Nga 1.497 rekomandimet nga raportet nga viti i kaluar, në vitin 2020 janë realizuar 831 rekomandime.²⁶

Njësitë për revizion të brendshëm në nivel në vitin 2020 kanë kryer 113 revizione për të cilat kanë shpenzuar 5351 ditë lidhur me revizionin (në vitin 2019 - 7939), gjegjësisht mesatarisht 47.35 ditë lidhur me revizionin (në vitin 2019 - 47).

Numri i ditëve të nevojshme të revizionit për një revizion sipas viteve është paraqitur në grafiqet vijuese:

Ditët e nevojshme të revizionit për një revizion sipas viteve



Ditët e nevojshme
të revizionit për
një revizion sipas
viteve

Progresi i arritur lidhur me revizionin e brendshëm në vitin 2020 në raport me vitin paraprak

NIVELI QENDROR	NIVELI LOKAL
- zголемување на бројот на основани единици за внатрешна ревизија за 1,1% (од 90 na 91) - rritja e numrit të njërive të themeluara për revizion të brendshëm për 1.1% (ng 90 në 91) - zголемување на вкупniот број внатрешни ревизори за 2,3 % (од 133 na 136)	- është kryer një revizion lidhur me programet e BE-së - zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera ad hoc (nga 10 në 8) - zvogëlimi i përqindjes së rekomandimeve të parealizuara prej 42.2% në 41.6% - rritja e numrit të revizioneve të kryera të

²⁵ E përlogaritur duke aplikuar treguesin “passport” – “Përqindja e rekomandimeve të zbatuara të revizionit të brendshëm”

²⁶ Për 114 rekomandime nga vitet paraprake dhe 187 nga viti 2019, nuk ka maturuar afati i realizimit.

• rritja e numrit të përgjithshëm të revizorve të brendshëm për 2.3% (nga 133 në 136) • намалување на бројот на просечно потрошени ревизорски денови за извршување на една ревизија за 4,8% (од 84 na 80) • ulja e numrit mesatar të ditëve të revizorve të harxhuara për realizim të të një revizioni për 4.8% (nga 84 në 80)	harmonizimit nga 72 në 74 • rritja e numrit të revizioneve të kryera të suksesshmërisë për 2% • rritja e numrit të revizioneve të kryera për monitorim të rekomandimeve për 2.2%
Mangësitë e përcaktuara lidhur me revizionin e brendshëm për vitin 2020 në raport me vitin paraprak	
NIVELI QENDROR • zvogëlimi i numrit të udhëheqësve për 10% (nga 50 në 45) • zvogëlimi i numrit të revizioneve kryera për 21% (nga 180 në 142) • zvogëlimi i numrit të rekomandimeve të dhëna për 24.65 (nga 925 në 697) • zvogëlimi i përqindjes së rekomandimeve të realizuara nga 66% në 60% • rritja e numrit të revizioneve të kryera ad hoc për 23.5% (nga 17 në 21) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të planifikuara për 2% (nga 204 në 200) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera për suksesshmëri për 50% (nga 4 në 2) • намалување на бројот на извршени ИТ ревизии за 50% (од 2 na 1) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera TI për 50% (nga 2 në 1) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera të kombinuara për 27.55 (nga 40 në 29) • në 7 subjektet e sektorit publik në nivel qendror²⁷ revizorët e brendshëm nuk i realizojnë vetëm punët lidhur me revizionin e brendshëm • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera financiare	NIVELI LOKAL • zvogëlimi i numrit të udhëheqësve për 5.3% (nga 19 në 18) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera për 29.8% (nga 161 në 113) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera sistematike për 44% (nga 36 në 20) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera financiare për 65% (nga 20 në 7) • zvogëlimi i numrit të revizioneve të kryera të kombinuara për 95.6% (nga 23 në 1) • nuk është kryer asnjë revizion TI (vitin paraprak është kryer një revizion TI) • zvogëlimi i numrit të rekomandimeve të dhëna për 35.6% (nga 990 në 637) • në 3 njësi të vetëqeverisjes lokale²⁸ revizorët e brendshëm nuk i realizojnë vetëm punët lidhur me revizionin e brendshëm

²⁷ Avokati i Popullit, Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Agjencia për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

²⁸ NJVL Gostivar, NJVL Berovë dhe NJVL Strugë

4. NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT

4.1. Aktivitetet e realizuara të Njesisë qendrore të harmonizimit në vitin 2020

Në vitin 2020, Njësia qendrore e harmonizimit vazhdoi t'i zbatojë reformat në kontrollin e brendshëm, të planifikuara në "Programin e reformës së menaxhimit të financave publike", "Politikat e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik (2019-2021)", me përkrahje të tuining projektit IPA 2018 "Përforcimi i funksioneve të planifikimit të buxhetit, realizimit dhe kontrollit të brendshëm", të financuar nga BE-ja.

Sipas "Programit të reformës së menaxhimit të financave publike" dhe në bashkëpunim me tuining projektin IPA 2018, u përpilua Propozim ligj të ri për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik, që ishte i harmonizuar me Propozim ligjin e ri për buxhetet dhe me standardet ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm dhe revizionit të brendshëm.

Ligji do të zbatohet nga të gjitha subjektet e sektorit publik, duke përfshirë të gjithë personat juridikë, që në mënyrë direkte ose indirekte janë themeluar nga shteti ose nga komunat dhe ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare, që aktualisht janë në pronësi të shumicës së pushtetit qendror, përkatësisht Qytetit të Shkupit ose një apo më shumë njësive të vetëqeverisjes lokale.

Risi në këtë ligj është fakti se të gjitha subjektet e sektorit publik, obligohen që proceset kyçe financiare t'i realizojnë veçanërisht në bazë të akteve të brendshme (rregullore, udhëzime etj.) të përpiluara në bazë të ligjeve përkatëse dhe akteve të tyre nënligjore.

Me këtë Propozim ligj, përforcohet kontrolli i brendshëm financiar përmes krijimit të sistemit të ri të llogaridhënies së udhëheqësisë. Përmes këtij sistemi, udhëheqësi i shfrytëzuesit të buxhetit do t'i japë llogaridhënie udhëheqësit të shfrytëzuesit buxhetor, ndërsa udhëheqësi i ndërmarrjes në pronësi publike do t'i japë llogaridhënie bordit mbikëqyrës dhe është i detyruar t'i monitorojë procedurat dhe udhëzimet e shfrytëzuesit buxhetor amë.

Në pjesën e revizionit të brendshëm, në ligj janë përcaktuar shfrytëzuesit buxhetor në nivel qendror, ku në mënyrë të detyruar vendosin njësi të revizionit të brendshëm, si dhe kritere të reja për vendosjen e revizionit të brendshëm te subjektet e tjera, me ç'rast merren parasysh: realizimi mesatar i buxhetit në tri vitet e fundit dhe numri i të punësuarve.

Gjithashtu, me këtë Propozim ligj, përcaktohet numri minimal i të punësuarve në njësitë e revizionit të brendshëm, mënyra e zbatimit të trajnimit dhe testi për marrjen e certifikatës për revizor të autorizuar të brendshëm në sektorin publik, vendoset detyrimi për përpilimin e Programit që i referohet sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të revizionit të brendshëm dhe zbatimit të kontrollit të cilësisë së aktiviteteve të revizionit të brendshëm nga ana e Njesisë qendrore të harmonizimit dhe përcaktohen kritere për themelimin e Komiteteve të revizionit te subjektet në sektorin publik.

Me këtë Propozim ligj, vendoset mënyra e re e raportimit lidhur me menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe revizionin e brendshëm, themelohet Këshilli i kontrollit të brendshëm financiar në

sektorin publik, si organ këshilldhënës i ministrit të Financave si dhe krijohet bazë për miratimin e akteve nënligjore brenda 18 muajve nga dita e miratimit të ligjit.

Propozim ligji për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik u publikua në RVNE në datë 3 nëntor 2020, ndërsa në datë 15 dhjetor të vitit 2020 u organizua debat publik ku ishin të pranishëm 35 përfaqësues të organeve të administratës shtetërore, sektorit joqeveritar dhe Delegacionit të BE-së në Shkup. Sipas komenteve të marra nga RVNE dhe debatit publik, Propozim ligji u shqyrtua nga Këshilli ekonomik dhe pastaj u miratua nga Qeveria në datë 28 dhjetor të vitit 2020. Në fillim të muajit janar 2021, Propozim ligji u dorëzua në Kuvend për miratim.

Njësia qendrore e harmonizimit në bashkëpunim me Akademinë nacionale të financave dhe ekonomisë së Holandës zbatoi vlerësimin e aktiviteteve kryesore të kontrollit të procesit “E drejta e shtesës së fëmijëve” dhe “E drejta e ndihmës së garantuar minimale” në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe në Qendrën e punës sociale – Shkup. Raporti për vlerësimin e kryer u dorëzua në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në datë 30 qershor të vitit 2020.

Realizimi i masave dhe aktiviteteve të theksuara në Programin e reformës së MFP dhe Strategjinë e KBFP është mbështetur nga BE-ja përmes tuining projektit IPA 2018 “Përforcimi i funksioneve të planifikimit të buxhetit, realizimit dhe kontrollit të brendshëm” në kuadër të Komponentit 2: “Përforcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik përmes implementimit efektiv të Politikës së KBFP”.

Njësia qendrore e harmonizimit në bashkëpunim me tuining projektin IPA 2018, të financuar nga BE-ja, në vitin 2020 përpiluan:

- Raport me analizë dhe rekomandime për përmirësimin e Planit aksional për periudhën 2019-2021 të Strategjisë së KBFP;
- Draft rregullore për formën dhe përmbajtjen e raporteve, plane aksionale dhe raport për cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm mbi Raportin vjetor të KBFP;
- Raport për evaluimin e veglave ekzistuese metodologjike sipas Propozim ligjit për KBFP dhe rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Udhëzim i ri për menaxhimin e rrezeve për institucionet e sektorit publik;
- Grup të punës për koordinim të aktiviteteve lidhur me themelimin e Akademisë së financave publike me detyrë të përgatitjes së analizës dhe propozimit lidhur me përzgjedhjen e modelit të organizimit të Akademisë.

Përveç këtyre aktiviteteve, Njësia qendrore e harmonizimit në datë 22 prill të vitit 2020, në faqen e internetit të Ministrisë së Financave e publikoi “Udhëzimin për punë të njësive të revizionit të brendshëm nga sektori publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga COVID-19”.

Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2019, i përpiluar nga Njësia qendrore e harmonizimit, u miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në datë 18 gusht të vitit 2020.

4.1.1. Aktivitetet e Komitetit për monitorimin e zbatimit të Politikës për kontroll të brendshëm financiar në sektorin publik

Në vitin 2020, Komiteti për monitorimin e zbatimit të Politikës së kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik vazhdoi me punë, ku anëtarë janë përfaqësues të Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë, Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministrisë së Financave – Sektor i KBFP.

Në datë 28 janar të vitit 2020, Komiteti shqyrtoi dhe miratoi raportin lidhur me progresin për periudhën korrik - dhjetor të vitit 2019, ndërsa në muajin korrik të vitit 2020, raportin për periudhën janar - qershor të vitit 2020.

4.1.2. Aktivitete në lidhje me kapitullin 32 – Kontrolli financiar

Për statusin dhe realizimin e masave dhe aktiviteteve në kapitullin 32 – Kontrolli financiar, Komisioni Evropian njoftohet rregullisht përmes Sekretariatit për Çështje Evropiane, ndërsa progresi në këtë kapitull u prezantua në takimin e Nënkomitetit të çështjeve ekonomike dhe financiare dhe statistikës, të mbajtur në datë 6 tetor të vitit 2020 në mënyrë virtuale.

Sa i përket të lartpërmendurës, Ministria e Financave propozon që Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta shqyrtojë Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2020 dhe t'i miratojë këto:

KONKLUSIONE

1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut shqyrtoi dhe miratoi Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2020.
2. Obligohen të gjitha ministrinë që deri në datë 10.05.2022:
 - të miratojnë Kodin e veçantë etik në të cilin mes tjerash, do të përcaktohet mënyra e veprimit ndaj rasteve të raportuara të sjelljes joetike dhe do të emërojnë person të autorizuar për etikë dhe do të themelojnë komitete etike;
 - ta përditësojnë dhe përmirësojnë misionin dhe vizionin e institucionit dhe t'i publikojnë ato në faqen e tyre të internetit;
 - t'i informojnë institucionet lidhur me qëllimet e tyre strategjike dhe programore në kompetencë të tyre (organet në përbërje, linja e dytë e shfrytëzuesve buxhetorë, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi të shtetit) dhe t'i obligojnë institucionet që planet e tyre operative t'i harmonizojnë me qëllimet strategjike dhe programore të ministrisë;
 - në aktet e brendshme të vendosin linja të qarta raportuese (kush, për çfarë dhe kujt i raporton) që udhëheqësve do t'u mundësohet monitorim i arritjes së qëllimeve të punës, mjeteve të ndara financiare, rezultateve dhe ndikimeve dhe veçanërisht monitorim të punës së institucioneve kompetente;
 - të sigurojnë ndarjen e detyrave/aktiviteteve veçmas për çdo të punësuar në planet vjetore të punës në njësitë e tyre të organizimit dhe institucionet kompetente;
 - t'i përcaktojnë rreziqet sa i përket përcaktimit të objektivave strategjike, programore dhe operative, duke marrë parasysh faktorët më të rëndësishëm të brendshëm dhe të jashtëm, përkatësisht ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit dhe institucioneve në kompetencë të tyre;

- ta përmirësojnë dokumentimin e rreziqeve në regjistrin e rreziqeve, sistemin e informimit mbi rreziqet e caktuara, si dhe zbatimin e masave për zvogëlim të rreziqeve në mënyrë që personi përgjegjës i institucionit do të marrë informacione në kohë lidhur me rreziqet më të konsiderueshme të ministrisë dhe institucioneve kompetente;
- gjatë përcaktimit të rreziqeve, t'i shqyrtojnë format e ndryshme të mashtrimit (falsifikimi i dokumenteve, dhënia e informacioneve të gabuara lidhur me gjendjen financiare dhe suksesshmërinë e përmbushjes së qëllimeve të caktuara, marrëveshjet e gabuara dhe faturat, dhënia e ryshfetit etj);
- të përgatisin procedura për realizimin e kontrollit administrativ dhe inspektues të pagesave të caktuara dhe përdorimin e donacioneve, transfereve, ndihmës dhe subvencioneve për shfrytëzuesit pëfundimtarë (në mënyrë që të kontrollohet nëse mjetet e ndara janë përdorur për qëllimin e destinuar, përndryshe të sigurojnë kthimin e mjeteve të shpenzuara në mënyrë të padestinuar);
- ta planifikojnë në dokumentet e tyre të planit, hartimin e:
 - sistemit të brendshëm të automatizuar të informimit me të cilin sigurohen të dhëna dhe informacione në kohë, të sakta dhe të plota dhe shkëmbimin e tyre midis njësive të brendshme organizative lidhur me nevojat e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, zbatimit të programeve, projekteve dhe aktiviteteve, si dhe monitorimin e arritjes së qëllimeve të punës dhe mjeteve të shpenzuara financiare dhe
 - sistemit të automatizuar të kontabilitetit ku do të përfshihet kontabiliteti i shpenzimeve dhe menaxhimit dhe sistemet e tjera të regjistrimit dhe bazave të të dhënave për qëllimet, rreziqet dhe informacionet e tjera financiare dhe jofinanciare në varësi të nevojave dhe specifikave të punës;
- të miratojnë Plan vjetor për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me proceset kyçe të menaxhimit dhe kontrollit financiar me plan për mënjanimin e mangësive dhe parregullsive dhe ta monitorojnë implementimin e tij në ministrinë dhe institucionet kompetente, të përpiluar në bazë të vetëvlerësimit të kryer dhe deklaratës mbi cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm;
- të sigurojnë realizimin e rekomandimeve të revizionit të jashtëm dhe të brendshëm në ministrinë dhe institucionet kompetente, ndërsa në rast të mosrealizimit të rekomandimeve, personi përgjegjës të ndërmarrë masa përkatëse.

3. Të gjitha ministritë obligohen që deri në datë 28.02.2022 në Qeveri të parashtrojnë Planin për organizim të revizionit të brendshëm, të përpiluar në bazë të analizës së kryer funksionale të ministrisë si shfrytëzues buxhetor amë, duke pasur parasysh numrin e të punësuarve dhe buxhetin e ministrisë, organet në përbërje, linjën e dytë të shfrytëzuesve buxhetorë, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi të shtetit në kompetencë të tyre, ku duhet ta kryejnë revizionin e brendshëm, nëse nuk kanë njësinë e tyre të revizionit të brendshëm ose nëse ajo nuk është funksionale.
4. Pas miratimit të Planit për organizim të revizionit të brendshëm nga ana e Qeverisë, në bazë të mendimit pozitiv të marrë paraprakisht nga ana e Ministrisë së Financave, ministritë duhet të bëjnë ndryshim dhe plotësim të akteve të organizimit dhe sistematizimit në pjesën e njësive të revizionit të brendshëm dhe deri në datë 31.12.2022 për ekipimin e tyre.
5. Ministritë, njësitë e revizionit të brendshëm që nuk kanë as udhëheqës as revizorë të brendshëm (Ministria e Kulturës, Ministria e Ekonomisë, Ministrisa e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive) obligohen që deri në datë 31.01.2022, t'i ekipojnë njësitë e revizionit të brendshëm me të paktën dy revizorë të brendshëm.
6. Të gjitha ministritë obligohen që ta informojnë Ministrinë e Financave – Sektori i kontrollit të brendshëm financiar publik për aktivitetet e ndërmarra, që i referohen konkluzioneve.
7. Ministria e Financave – Sektori i kontrollit të brendshëm financiar publik obligohet që në Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2021, ta informojë Qeverinë lidhur me realizimin e këtyre konkluzioneve.

SHTOJCAT

Shtojca 1

Shqyrtim

lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, që nuk kanë dorëzuar Raportin vjetor financiar

Nr. r.	Emri i institucionit
1.	Komisioni Rregullator për Banim
2.	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut
3.	Byroja për Përfaqësimin e RM-së para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
4.	Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve
5.	Inspektorati Shtetëror Devizor
6.	Enti Shtetëror për Mbrojten e Pronësisë Industriale
7.	Inspektorati Shtetëror i Transportit
8.	Inspektorati Shtetëror i Punës

Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
1.	Bogovinë	8.	Likovë	15.	Sopishtë
2.	Vrapçisht	9.	Mavrovë dhe Rostushë	16.	Nagoriçan i vjetër
3.	Debarcë	10.	Petrovec	17.	Studenica
4.	Demir Kapi	11.	Probishtip	18.	Tearcë
5.	Dojran	12.	Rankovcë	19.	Çair
6.	Zhelinë	13.	Rosoman	/	/
7.	Konçe	14.	Saraj	/	/

Shtojca 2

Shqyrtim
lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar Strategji për
menaxhimin me rreziqet

Nr. r.	Emri i institucionit
1.	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
2.	Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës
3.	Komisioni Rregullator për Banim
4.	Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi
5.	Agjencia Operative Teknike
6.	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut
7.	Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta
8.	Ministria për Sistem politik dhe Marrëdhënie midis Bashkësive
9.	Agjencia për Menaxhim me Pronën e Konfiskuar
10.	Agjencia për Zbatimin e Gjuhës
11.	Ministria e Mbrojtjes
12.	Agjencia për Siguri Nacionale
13.	Drejtoria për Mbajtjen e Librave Amë
14.	Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve
15.	Inspektorati Shtetëror Devizor
16.	Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale
17.	Inspektorati Shtetëror i Tregut
18.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
19.	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor
20.	Inspektorati Shtetëror Komunal
21.	Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural
22.	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor
23.	Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale
24.	Agjencia e Emigracionit
25.	Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
26.	Byroja për Zhvillim Rajonal
27.	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
28.	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
1.	Haračinë	16.	Zhelinë	31.	Pehçevë
2.	Bogovinë	17.	Zelenikovë	32.	Plasnicë
3.	Bosilevë	18.	Zërnovc	33.	Radovish
4.	Bërvenicë	19.	Kavadar	34.	Rankovcë
5.	Vasilevë	20.	Kisella Vodë	35.	Rosoman

6.	Vrapçisht	21.	Kërçovë	36.	Saraj
7.	Gjevgjeli	22.	Konçe	37.	Sh. Nikollë
8.	Gradsko	23.	Likovë	38.	Sopishtë
9.	Dibër	24.	Llozovë	39.	Nagoriçan i Vjetër
10.	Debarcë	25.	Mavrovë dhe Rostushë	40.	Studenica
11.	Dellçevë	26.	Makedonska Kamenicë	41.	Tearcë
12.	Demir Kapi	27.	Mogillë	42.	Tetovë
13.	Demir Hisar	28.	Negotinë	43.	Çair
14.	Dojran	29.	Novaci	44.	Çashkë
15.	Dollnen	30.	Novo Sellë		/

Shtojca 3

Shqyrtim

lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë përpiluar Regjistër të rreziqeve

Nr. r.	Emri i institucionit
1.	Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
2.	Enti Shtetëror i Revizionit
3.	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
4.	Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës
5.	Komisioni Rregullator për Banim
6.	Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
7.	Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse
8.	Agjencia Operative Teknike
9.	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut
10.	Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë
11.	Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta
12.	Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Bashkësive
13.	Agjencia për Menaxhim me Pronën e Konfiskuar
14.	Agjencia për Zbatimin e Gjuhës
15.	Ministria e Mbrojtjes
16.	Ministria e Punëve të Brendshme
17.	Agjencia për Siguri Nacionale
18.	Drejtoria për Mbajtjen e Librave Amë
19.	Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve
20.	Drejtoria e Policisë Financiare
21.	Inspektorati Shtetëror Devizor
22.	Agjencia për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

23.	Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale
24.	Inspektorati Shtetëror i Tregut
25.	Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik
26.	Enti Shtetëror për Mbrojtje të Pronësisë Industriale
27.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ujërave
28.	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor
29.	Inspektorati Shtetëror i Transportit
30.	Inspektorati Shtetëror Komunal
31.	Inspektorati Shtetëror i Punës
32.	Byroja për Zhvillimin e Arsimit
33.	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor
34.	Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale
35.	Agjencia e Emigracionit
36.	Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
37.	Byroja për Zhvillim Rajonal
38.	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
39.	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
40.	Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr. r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
1.	Haračinë	18.	Dollnen	35.	Petrovec
2.	Manastir	19.	Zhelinë	36.	Pehçevë
3.	Bogdanc	20.	Zelenikovë	37.	Plasnicë
4.	Bogovinë	21.	Zërnovc	38.	Radovish
5.	Bosilevë	22.	Kavadar	39.	Rankovc
6.	Bërvenicë	23.	Kisella Vodë	40.	Rosoman
7.	Vasilevë	24.	Kërçovë	41.	Saraj
8.	Vinicë	25.	Konçe	42.	Sh. Nikollë
9.	Vrapçisht	26.	Kriva Pallankë	43.	Sopishtë
10.	Gjevgjeli	27.	Likovë	44.	Nagoriçan i Vjetër
11.	Gradsko	28.	Lozovë	45.	Strugë
12.	Dibër	29.	Mavrovë dhe Rostushë	46.	Studenica
13.	Debarcë	30.	Makedonska Kamenicë	47.	Tearcë
14.	Dellçevë	31.	Mogilë	48.	Tetovë
15.	Demir Kapi	32.	Negotinë	49.	Çashkë
16.	Demir Hisar	33.	Novac	50.	Shtip
17.	Dojran	34.	Novo Sellë		/

Shqyrtim

lidhur me shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal që nuk kanë dorëzuar raport për revizionet dhe aktivitetet e kryera të revizionit të brendshëm

Nr. r.	Emri i institucionit
1.	Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
2.	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
3.	Komision për Mbrojtjen e Konkurrencës
4.	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ²⁹
5.	Komisioni Rregullator për Banim
6.	Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
7.	Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse ³⁰
8.	Agjencia Operative Teknike ³¹
9.	Sekretariati për Legjislacion ³²
10.	Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive
11.	Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Bashkësive
12.	Agjencia për Zbatimin e Gjuhës ³³
13.	Qendra për Menaxhim me Kriza
14.	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
15.	Drejtoria për Mbajtjen e Librave Amë
16.	Byroja për Përfaqësimin e RMV-së para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ³⁴
17.	Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve
18.	Inspektorati Shtetëror Devizor
19.	Ministria e Ekonomisë ³⁵
20.	Agjencia për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
21.	Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit
22.	Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale ³⁶
23.	Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik
24.	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor
25.	Inspektorati Shtetëror i Transportit

²⁹Nuk është dorëzuar RV (raport vjetor) për revizion të brendshëm edhe pse kanë lidhur marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë për kryerjen e revizionit të brendshëm.

³⁰Njoftimi se nuk është krijuar funksioni i revizionit të brendshëm pavarësisht disa përpjekjeve për nënshkrimin e marrëveshjes për kryerjen e funksionit të revizionit të brendshëm me një subjekt tjetër

³¹Njoftimi se nuk kanë krijuar funksionin e revizionit të brendshëm, por në vitin 2020 është marrë mendim pozitiv për kryerjen e funksionit të revizionit të brendshëm nga NJRB-ja e Agjencisë së Zbulimit

³²Njoftimi se pavarësisht se kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë për kryerjen e revizionit të brendshëm është planifikuar edhe revizion, por ai nuk është kryer dhe RV nuk është përgatitur

³³Njoftimi se nuk është punësuar asnjë person në departamentin e revizionit të brendshëm, formulari i RV-it për RB nuk është plotësuar edhe pse është përmbajtur në Deklaratën e udhëheqësit të subjektit

³⁴Njoftimi se kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë për kryerjen e revizionit të brendshëm

³⁵Njoftimi se për shkak të personelit të pamjaftueshëm të NJRB-së nuk janë në gjendje që t'i dorëzojnë RV për RB

³⁶Njoftimi se është themeluar NJRB është dorëzuar, por ajo nuk është ekipuar dhe formulari i RV nuk është plotësuar

26.	Inspektorati Shtetëror i Ndërtimtarisë dhe Urbanizmit ³⁷
27.	Inspektorati Shtetëror Komunal
28.	Inspektorati Shtetëror i Punës ³⁸
29.	Byroja për Zhvillimin e Arsimit
30.	Inspektorati Shtetëror Administrativ
31.	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor
32.	Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale
33.	Agjencia e Emigracionit
34.	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut ³⁹

Nr. r.	Institucioni
1.	Komuna e Dollnenin
2.	Komuna e Gazi Babës ⁴⁰
3.	Komuna e Radovishit ⁴¹
4.	Komuna e Shtipit ⁴²
5.	Komuna e Kërçovës
6.	Komuna e Haračinës ⁴³
7.	Komuna e Bogdancit
8.	Komuna e Bosilevës
9.	Komuna e Vasilevës ⁴⁴
10.	Komuna e Gjevgjeliës
11.	Komuna e Dibrës
12.	Komuna e Demir Kapisë
13.	Komuna e Karposhit ⁴⁵
14.	Komuna e Konçes
15.	Komuna e Likovës
16.	Komuna e Mavrovës dhe Rostushës
17.	Komuna e Negotinës ⁴⁶
18.	Komuna e Novo Sellës
19.	Komuna e Petrovecit
20.	Komuna e Plasnicës
21.	Komuna e Rankovcës
22.	Komuna e Sarajit ⁴⁷
23.	Komuna e Sopishtes ⁴⁸
24.	Komuna e Staro Nogoriçanit

³⁷Në shkresë theksohet se nuk është krijuar funksion për revizionin e brendshëm dhe për shkak të kësaj është dorëzuar raport i nënshkruar i zbrazët, ndërsa deklarata i referohet edhe RB

³⁸Njoftim se nuk është krijuar funksioni për revizionin e brendshëm

³⁹Njoftim se për shkak të mungesës së personelit, RV-i nuk është dorëzuar RV-i për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm

³⁹Njoftimi se nuk kanë revizion i brendshëm

⁴⁰Në bisedë telefonike është raportuar se RV-i është përpiluar, por për shkak të masave për mbrotje nga COVID-19, ata nuk arritën të nënshkruanin dhe të dorëzonin atë.

⁴¹Departamenti me 2 të punësuar nga të cilët udhëheqësi i departamentit është në pushim të lehonisë

⁴²Departamenti me 1 të punësuar, që sipas informacioneve të marra në bisedën telefonike, është në pushim të lehonisë

⁴³Njoftimi se funksionin e revizionit të brendshëm kryen revizor i brendshëm në bazë të marrëveshjes, por sipas të dhënave të Njesisë qendrore të harmonizimit, ky person është në pension

⁴⁴Njoftimi se nuk kanë revizion i brendshëm

⁴⁵Njoftim se nuk kanë revizor të brendshëm dhe nuk do të dorëzojnë raport

⁴⁶Njoftim se nuk kanë revizor të brendshëm dhe nuk do të kenë mundësi që të dorëzojnë raport

⁴⁷Marrëveshje me komunën e Çairit

⁴⁸Marrëveshje me komunën e Kisella Vodës

25.	Komuna e Studeniçanit
26.	Komuna e Tearcës
27.	Komuna e Dojranit
28.	Komuna e Çairit ⁴⁹
29.	Komuna e Gjorçe Petrovit

⁴⁹ Udhëheqësit të njësive i ndërpritet përkohësisht marrëdhënia e punës